

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shefja e painformuar e shërbimit Informativ...
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/shefja-e-painformuar-e-sherbimit-informativ-i587768
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:46:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 18:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4f238f42eb93b96dd042d4b5178c1e58fd10a5a86fdee1735ed0b215e0f1e7ce
TEKSTI	4b352416ebe0176360ad58a0da902e835245d2bd53920e2b836f9787536fa3fe
PAMJA	e1c9467e8fc3f351e2ad69d726c56137b11731ed2b2cfdc9fcb94ba0a5d6c5e3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8a15df22ff20a39a341f8512249f8499c5deb8ae5825d3207215dbb554da0da3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8a15df22ff20a39a341f8512249f8499c5deb8ae5825d3207215dbb554da0da3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 [English](#)



1 e [Zelensky llet ne OKB: Moska ka pesuar humbje poshteruese! Vetem nje njeri deshiron lutte ne Ukraine](#)Çmimet e banesave t'renojne rritjen, por nuk u len duhen me shun fundit

Shefja e painformuar e shërbimit Informativ...



22 Shtator 2026, 20:50Blog Nga Ylli Manjani

Nuk e njoh Vlora Hysenin. Por ç' nuk kam dëgjuar për të! Lloj-lloj teorish, konspiracionesh, legjendash urbane, analizash televizive dhe ekspertësh që dinë gjithçka për inteligjencën, përveç asaj se çfarë bën inteligjenca.

Di vetëm se është një shqiptare nga Kosova, e cila sipas lajmeve nuk i paskësh pasur punët fort mirë as atje. Po, sinqerisht, kjo është pjesa më pak interesante e historisë.

Në planin e spektaklit politik, gjetja e një emri nga Kosova dhe, për më tepër, një gruaje për ta katapultuar në krye të Shërbimit Informativ të Shtetit ishte një gjetje. Debatit shpërtheu menjëherë. Kush është, nga vjen, pse ajo, pse jo një tjetër?

Kështu arrit objektivi. U fol për drejtoreshën, por askush nuk foli për SHISH-in.

Një institucion që teorikisht duhet të jetë syri dhe veshi i shtetit, u bë aq i padukshëm sa sot lind pyetja më serioze: A ekziston ende SHISH në funksion, apo ekziston vetëm godina?

Me se merret ky institucion?

Vazhdon të mburret se ka pajisje përgjimi? Vazhdon t'u japë zyra shërbimeve partnere? Apo ka ende burime të veta informative, njerëz në terren, analiza, kundërzbulim, inteligjencë strategjike?

Sepse, nga jashtë, duket sikur inteligjenca shqiptare është bërë një klub thashethemesh me vulë shtetërore.

Dikur SHISH ishte institucion që prodhonte mister. Sot prodhon vetëm heshtje. Dhe heshtja nuk është gjithmonë sekret shtetëror. Ndonjëherë është mungesë aktiviteti.

Çudia më e madhe është se askush nuk i bën më pyetje SHISH-it. Ligjin nuk ia prek njeri. Raportet mezi lexohen. Komisionet parlamentare e trajtojnë si një dosje që nuk hapet kurrë. Gjithmonë bëhet pak sherr për emërimin ose shkarkimin e drejtorit të radhës dhe pastaj... perde.

Çfarë ndodh brenda asaj drejtorie është ndoshta sekreti më i madh që ka zbuluar ndonjëherë SHISH-i: askush nuk e di.

Në këtë kuptim, drejtori i SHISH-it është ndoshta funksionari më i vetmuar i Republikës. Nuk ka elektorat, nuk ka tifozë, nuk ka protestues. Ka vetëm dekret emërimi dhe, kur vjen dita, dekret shkarkimi.

Edhe për drejtoreshën Vlorë kështu do të ndodhë. Dy ditë debat, tre studio televizive, katër "burime pranë hetimit" dhe, sapo të dalë emri i drejtorit të ri, dosja politike mbyllet.

Personalisht, më vjen keq për Vlorën si njeri që i është dashur të kryejë një detyrë pa asnjë tifoz. E vetmja femër drejtor që përfundon në ndjekje penale, kur burrat paraardhës e meritonin atë.

Për më tepër, të jesh nën hetim, të përballesh me akuzat dhe me gjithë peshën e një procesi penal nuk është aspak gjë e lehtë. Dhe disa prej pyetjeve që ngrihen publikisht duken të pazakonta. Për shembull: çfarë sekreti të lidhur me AKSHI-n duhet të dinte shefja e SHISH-it? Nuk është fusha klasike e detyrave funksionale të shërbimit sekret.

Por mbetet për tu sqaruar në vijim, ndoshta me zakonin e njohur, me gazetarët që do marrin lajme "në burim"...

Por humori i zi fillon diku tjetër.

Drejtoresha e shërbimit të fshehtë arrestohet... fshehtas.

Pra, njeriu që duhet të dijë çfarë ndodh në errësi, nuk paska ditur çfarë po ndodhte pas shpinës së vet.

Imagjinoni skenën.

Shërbimi sekret paska mbajtur sekret... arrestimin e shefes së shërbimit sekret. Apo më keq akoma, SHISH ska ditur gjë?!

Drejtoresha duhet të ishte në zotërim të botës së fshehtë. Të nuhaste rrezikun para se të vinte. Të dinte se kush e ndjek, kush e vëzhgon dhe kush troket në derë.

Mirëpo nuk paska ditur gjë, ndaj nuk mbrojti dot as veten.
Lëre pastaj sigurinë e kombit.

Pothuajse shumicën e arrestimeve të fshehta që vendos SPAK me GJKKO, personat e interesuar i marrin vesh. Drejtoresha e SHISH jo.

Prandaj, drejtoresha paska qenë e paafte. Për veten e vet të paktën.

Në fakt, nëse shefja e inteligjencës surprizohet me vendime të fshehta, atëherë problemi nuk është vetëm personi. Problemi është institucioni që prej kohësh na ka bindur se sekretet i tij më i madh është... se është kot fare sa nuk e merr vesh as kur lëshojnë urdhër arreste për të.

Ndaj jam kurioz të kuptoj çfarë sekreteve paska patur drejtoresha e pajftuar, për çështjen "AKSHI"?!

Zakonisht për shkak të nivelit të sekreteve që duhet të ketë SHISH, nxjerrja e tyre quhet spiunazh. Nëse e gjykojmë nga niveli i ulët i sekretit të përhapur, për të cilin hetohet, del që drejtoresha paska qenë vërtetë e paafte për atë detyrë.

34 Komente



Oi, oi

22 Shtator 2026, 21:35

Nuk e di pse ba duhet një institucion i tillë. Qindra njerëz që marrin rrogën kot dhe gjithë ditën merren me bizneset e tyre familjare. Njoh disa të tillë. Të shkrihet komplet. Se dëgjova që do të emërohet shefi i ri i SHISH.....

↩ **Përgjigjuni**

👍 21 🗳️ 9 ❤️ 0



Shefi

22 Shtator 2026, 21:52

Injorant, nje bote e tere ka sherbim informativ

↩ **Përgjigjuni**

👍 18 🗳️ 4 ❤️ 0



Dire Straits !!!!!

22 Shtator 2026, 22:06

Ja edhe YDHI , perfaqesuesi i shkerdhatokracise juridike , shpejtoi te beje artikullin e tij.....o Ydhi , SPAK varet nga amerikanet , dhe keta te fundit nuk i pergjon dot as Vlora , e as bojaxhiu.....fakti qe puna ka shkuar deri te shefja e SHISH , tregon se ceshtja e AKSH-it eshte nje mega afere qe nuk dihet edhe ku tjetër do ti dale tymi....shpresoj qe bojaxhiu te kete siguruar zjarrfikese ne Surrel , qe te mos arrije zjarri deri atje dhe na djeg bunkerin pastaj....!!!!

↩ **Përgjigjuni**

👍 4 🗳️ 32 ❤️ 0



dire straits

23 Shtator 2026, 07:51

gjallë qenke !?se sikur pate munguar ca kohë

↩ **Përgjigjuni**

👍 2 🗳️ 4 ❤️ 0

U ujku i balles (ballu(j)ku)

23 Shtator 2026, 20:00

shteti albanania eshte bere burdello, qe kur nudisti bojaxhi ia hypi siper. nga nje gojore ne tjetren, nga nje llape ne tjetren rreshqisnin dhe sekretet e shtetit kurve neper baxhella e kodosher. mbase i kane shqiptuar gabim se gojerat i kane pasur plot keshtu qe e folmja ka dale si mblacitje-gelltitje-peshtyme. dhe pastaj kane ngaterruar karin me dollarin. mbase.

↩ Përgjigjuni

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0

K Kutuzovi

22 Shtator 2026, 23:36

Oi,Oi,o gomar! Nuk ka asnje vend te botes pa sherbmin informativ. Ky institucion eshte i domosdoshem per nje shtet. Prandaj mos fol kot pa pergjegjesi.

↩ Përgjigjuni

👍 5 🗳️ 1 ❤️ 0

K KRAHEMARRJE NA VERASEMES

23 Shtator 2026, 13:34

O K@riiii, ai po thote ... per ty o k@r SHEFI dhe njerez si puna yte... qe jane inekzistent dhe jo te vlefshem per te garantuar sigurine e kombetare si dhe interesat e kombit SHQIPTAR. Niveli tyre eshte me keq se ç' paraqet ne komentin e tij Oi, oi, pasi jane punesuar njerez qe as e kan idene se cfare misioni dhe detyrash funksionale kane si punonjes te atij institucioni... dhe ata qe punojne vazhdojne me avazin: DRO BI SHI, DRO S' BI SHI, pra jane brenda ene po s'ra shi "ai" justifikohet me te thash "DRO BI".

↩ Përgjigjuni

👍 1 🗳️ 0 ❤️ 0

A Argita

23 Shtator 2026, 06:50

E qartë që SHISH u përgjuaka nga SPAK! Po SPAK nga kush përgjohet? Mbase nga Xhafaj?

↩ Përgjigjuni

👍 4 🗳️ 3 ❤️ 0

K Kolegu i spak-ut

23 Shtator 2026, 09:52

Xhafaj është deputet i zgjedhur me votë nga populli, dhe ka të drejtë të bëjë një hetim parlamentar ku zyrtare të shërbimeve japin përgjigje deputetëve të ngarkuar me punë për atë çështje. Xhafaj nuk përgjon dot shërbimet por ka të drejtë në bazë të ligjit që ata të raportojnë për punën e tyre

↩ Përgjigjuni

👍 2 🗳️ 0 ❤️ 0

S Skypion

23 Shtator 2026, 08:29

I nderuar avokati yne strategjik, ke kapur nje aspekt te lajmit te bujshem, dhe e tjerr. Keshtu mund te shkruash pafund, por kjo eshte shmangje nga thelbi i gjese. Ja, bie fjala, mund te dali dikush tjeter te flase per aferen hedonistike te Vlores me Gysin...! Meqe je edhe analist, duhet te lexosh edhe shkrimet e kolegeve te tu, qe trajtojne pikerisht thelbin e problemit, qe eshte kapja e institucionit themelor te sigurise nga krimi; dhe me tej, kapja e vet shtetit nga ai. Per kete ben lajm arrestimi i drejtores se SHISH. Lajm eshte edhe shkarkimi i menjehershem nga Kerrma dhe dekretimi edhe me i menjehershem nga Barom Sheqeri. Se lind pyetja: pse e beri kete bidat Kerrma, qe nuk e kishte bere me asnje tjeter me pare?! A kane gisht partneret tane ne kete histori?! Ja keshtu. Padyshim qe kane gisht, dore dhe kembe. SHISH eshte i vetmi institucion, ne te cilin, nuk behet asgje pa izmen e nderkombetareve. Eshte si te thuash institucioni i tyre. Por kjo eshte pjese e nje strategjie me te madhe, qe ka te beje me spastrimin e politikës shqiptare, para anetaresimit ne BE. Eshte vendosur qe Shqiperia do te antaresohet ne BE, por pa Kerrmen. Te gjithë anetaret kryesore te Organizates Kriminale Shteterore, jane arrestuar tashme; pervec lubise, qe do te arrestohet se shpejti. Ka mbetur vetem kryetari i Organizates, Kerrma. Thone, thuhet, edhe une thoja, qe pas kesaj jane amerikanet. Tani nuk jam i sigurte. Jane me shume europianet. Sidomos gjermanet.

nuk me shqitet nga mendja keshtu qe Arta Dade i dha kermes para qy muajsh: meso gjermanisht: Eshte per te qesur se ajo shprehja, e keqja vjen andej nga se pret, eshte tamam per rastin e Kermes, qe ka besuar se e di shume mire nga i vijne te mirat dhe te keqijat. Nje muut din.

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 7 ❤️ 0



Rroku

23 Shtator 2026, 08:56

Skypordh, shko mor zog gomarit Psikopat Ti ben analize halesh Moos u lodh me AI Idiot inteligjent

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 5 🗳️ 0 ❤️ 0



TOROLLAKIS SQIPION

23 Shtator 2026, 14:44

O S k@r pordha, çere lidhje ka SHISH me spastrimin e politikës??? O bole pa koqe brenda, SPATRIMIN e ben drejtesia (prokurori, gjykate) dhe jo SIGURIMI shtetit si ne kohen e zhazhit Enver... Kermes ti ti hash menderen dhe ate qe derdhet per tek kanali i kenetes, ku jeni zhytur ju SHQUP-istët e KERMES REALE te PD S al HALE Shi Qi re Birishoviq, prandaj shko ha m...u..T aty ku jeni mesuar.

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0



Bureto

23 Shtator 2026, 12:53

Tani e tutje, sa herë të flitet për SHISH-in dhe Vlora Hysenin, menjëherë do më kujtohen Edgar Huver 28 vjet në drejtimin e FBI-s amerikane dhe padyshim famëkeqi Bashkim Gazidede, "gjenerali" i vitit të zi 1997, në Shqipëri.

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 0 🗳️ 0 ❤️ 0



SPAK- politik

22 Shtator 2026, 21:50

Mos valle kjo shefja e SHIK-ut ka informacione per prokuroret e SPAK-ut???? Pse duhet te arreshtohet kur ishte jashte ne mbledhje ne nivele te larta qe te diskreditohej edhe shteti per kete zyrtarevte nivelit te larte???? Ata prokurore do i kete cenuar diku ajo.... SPAK po nderrmerr veprime politike... kjo eshte e papranueshme

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 34 🗳️ 10 ❤️ 0



Plaku Xhuxhumaku

22 Shtator 2026, 22:33

Po mo trap ka informacione, por duke i rënë klarinetës se Gysit

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 7 🗳️ 12 ❤️ 0



Nga burime te sigurta ju flet klodi fytyr kali

22 Shtator 2026, 22:12

Si cdo institucion,edhe ky eshte vetem per te mare rrogen,nuk e di ,keta kane te drejte ta rrisin vete rrogen si dumdumet.... Po te kryenin detyren institucionet apo ata qe punojne ne to,nuk do ishim ketu ku jemi.... Rrumpall 30 vjecare ne dosjet e drejtesis,ne kadastra,ne ndertime e legalizime,ne shkolla e kudo... Shiku,shishi etj di me pak se saliu,se salianji me griden apo muli me gazpedon.... Na foli dhe mjelsja e dhive sot,gjeja me e zgjuar qe tha,e solli edi rama dhe e arrestoi spaku,gjetje gjeniale

↩ [Përgjigjuni](#)

👍 14 🗳️ 2 ❤️ 0



Ard

22 Shtator 2026, 22:12

Ndodhi kjo qe te kujtoheshim se ekziston SHISH , ketu gelojne spiunet ne te gjitha institucionete Shtetit dhe SHISH nuk ka vepruar asnjhere .

↩ **Përgjigjuni**

👍 1 🗳️ 0 ❤️ 0



Tironsi

22 Shtator 2026, 22:17

T'i shkrijmë të tëra meqë i ka dhjerë Rama. Ti Idhi, nirë lëpirës dhe harbut, po qeke dhe pallë cari. Simas teje SHIKU duhet të survejojë SPAKun, që të dijë parakohe kundër kundër kujt dalin urdhërarrestet dhe kjo Vlora paska qenë e paaftë për këtë arsye. Vari qillot

↩ **Përgjigjuni**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.